



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0017165-1/25 dt. 28.03.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 38

Koha: 28.03.2025 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri
Drejtorët e Drejtorive
Mungoi: Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 38-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me e-mail ka ardhur edhe Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, i cili propozohet të hyjë në rend dite.

Muhamed Hoti: Këtë propozim-vendim tek dje e kam pa edhe nuk kam mundur ta hapi linkun që e keni dërguar, nuk e di a është ndonjë problem teknik apo problemi me e-mailin zyrtar, është mirë që kjo pikë mos të kalojë deri sa të sqarohet në tërësi, para procedimit në Kuvend është mirë që të gjejmë një gjuhë të përbashkët dhe nga zonat 1 deri në 7 të ngritët koeficienti për 1.

Vesa Broja: Muhamet e ka marrë pjesë në diskutimin publik për hartën zonale dhe a ke jep sugjerimet tua.

Muhamed Hoti: Kam marrë pjesë në një takim me publikun, unë mendoj se të gjitha zonat duhet të ngritën për 1 koeficient.

Drita Kadriu: Propozoj që në rend dite të hyjë edhe Kërkesa për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999". Këtë kërkesë e ka bërë Enis

Keimendi i cili po mbledh informata për të dëshmuar krimet serbe në arsimin në Mitrovicë, shuma e kërkuar për subvencionim është 12,000 €, ky libër do t'i ketë 400-600 faqe.

Hysen Muzliukaj: E përkrahi si iniciativë, por për Kuvend të na vije propozim-vendimi i detajuar, të jetë në harmoni me Rregulloren Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, si dhe baza ligjore e këtij propozimi të harmonizohet me Zyrën Ligjore. Ne nuk e dijmë ku do të merren këto mjete dhe a do të ipen për personin në fjalë apo për shtëpinë botuese.

Drita Kadriu: Për mbledhjen e Kuvendit propozimi do të jetë i harmonizuar dhe i kompletuar.

Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim propozimin që pikë e 3 e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032.

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi me shumicë votash (5 për, 1 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 3 e rendit të ditës të jetë: Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032.

Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim propozimin që pikë e 4 e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999".

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi unanimisht (8 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 4 e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999".

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024
3. Propozim vendimi për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032
4. Kërkesa për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999"

Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 2

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtorit të DPU-së z. Edison Tërnavë.

Pas arsyetimit të Propozim vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032 nga ana e Drejtorit të DPU-së z. Edison Tërnavë, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Fadil Veseli: E mora fjalën për dy arsye, e para materiali ka ardhur me vonesë dhe ne nuk kemi arritur me pa në detaje çka përmban ky plan dhe e dyta unë kam dyshimet e mia duke u bazuar edhe në të kaluarën, kur është fjala të ndërtimeve si shoqëri kemi dështuar, sepse për shkak të moskryerjes së punëve siç duhet në çdo ditë po përballemi me telashe, nuk jam ekspert i këtij lëmi, por çka po më intereson mua si qytetar i thjeshtë ndërtesa po ndërtohen edhe sot ndërsa nuk ka vend për parkingje as për biçikleta se lëre më për vetura, nuk po respektohet ligji në fuqi, për këtë arsye i kam rezervat e mia, prandaj drejtor kish qenë mirë këtë plan me na e prezantuar me një projektor që të jemi të informuar saktë se çka po propozohet. Tek zona të liqeni ne të gjithë duhet të jemi të interesuar ta mbrojmë zonën të liqeni, zonë e cila ka mbete ikonë e Mitrovicës për me tërhequr vizitorë nga jashtë komuna dhe nëse aty fillohet me ndërtim qysh është duke vazhduar, do të bëhet katrohurë, ujërat e zeza dalin në liqe, atëherë çka, problemi i koeficientit për mua është problem i vogël, çështja e infrastrukturës është më e rëndësishmja, pa infrastrukturë nuk kisha lejuar as ndërtim, kah do të shkojnë ujërat e zeza, kanalizimi, pastaj ndriçimi, rryma, nuk kemi arsye të tolerojmë asgjë sepse po fillon një lagje e re, e nëse bëjmë gabime deri më sot atëherë ku do të mbesim. Prandaj lidhur me këtë propozim unë do të abstenoj sepse nuk i kam informatat e mjaftueshme lidhur me të.

Edison Tërnavaj: Sa i përket infrastrukturës dhe ndërtimeve në përgjithësi me hartë zonale kriteret janë më të rënda edhe janë në disfavor të ndërtuesve, ndërsa sa i përket pjesës së liqenit në mandatin e kaluar është miratuar PZHK dhe ajo pjesë është e paraparë për ndërtim.

Hysen Muzliukaj: Propozim-vendimi ka të bëjë me vitet 2024-2032, vendimi prej Ministrisë ka ardhur me datë 13.11.2024, ne jemi në vitin 2025, viti 2024 ka kaluar, çka me bë me lejet që janë dhënë për hartën zonale në vitin 2024, prandaj kërkoj përgjigje nga ju drejtor pse kjo pikë nuk ka ardhur për shqyrtim prej datës që e ka sjellë Ministria deri sot. PZHK-ja është miratuar në vitin 2020, nëse ne sot e miratojmë këtë vendim 2025-2032 çka ndodhë në vitin 2028 kur PZHK-së i del afati, proceduralisht me na treguar se çka do të ndodhë për këto dy pika, pse vonesë për afër 4 muaj dhe të jemi korrekt Harta Zonale është derivat i PZHK-së, çka do të bëjmë ne pas 3 viteve kur PZHK-së i del afati.

Edison Tërnavaj: Harta Zonale si dokument është më i fuqishëm se PZHK-ja sepse i cakton të gjitha kushtet, kriteret për zhvillim të atij plani. Data kur ne e kemi pranuar këtë dokument ka qenë data 20.11.2024, momentin e pranimit të këtij dokumenti ne kemi filluar me i zhvilluar të gjitha procedurat me komision, MMPH nuk i ka miratuar disa kërkesa të qytetarëve, komi pasë komunikim me Ministrinë sidomos për pjesën e zonës së Shalës, në muajin janar kemi pasë ankesë për çështjen e turbinave të erës për disa ndërtime që kanë ndodhë në atë zonë, me PZHK dhe Hartë zonale është paraparë zhvillimi i turizmit në atë zonë, pastaj edhe fushata dhe në muajin shkurt me komision kemi vendosë që sipas vendimit të ministrisë të vazhdojmë tutje, si dhe ankesat e qytetarëve t'i drejtohen Ministrisë.

Hysen Muzliukaj: Në momentin që ka ardhë vendimi prej Ministrisë më nuk ka pasur nevojë me u merr me kërkesat e qytetarëve, s'keni pasur as të drejtë as juridikisht e as proceduralisht, sepse është vendim i Ministrisë, atëherë është dashur vetëm të sillet në Kuvend për shqyrtim. Kërkesat e qytetarëve nuk janë të bashkangjitura në material. Harta Zonale e ka një afat që duhet me u miratuar.

Edison Tërnavaj: Ne i kemi shkresat që i kemi dërguar në Ministri prej vitit 2023, ata janë vonuar që nuk është miratuar brenda 15 muajve.

Muhamed Hoti: Kur ka ardhë Harta Zonale për shqyrtim herën e parë në KPF, ka qenë prezent edhe Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza, unë i kam hamendësimet e mia sepse nuk po e kuptoj kjo punë a po kryhet për lëvdatë apo për inate. Kur i kam thënë Kryetarit që Mitrovica ka nevojë për zhvillim, e gjatë zhvillimit hyn edhe faza e ndërtimeve të larta, përgjigja e vetme e Kryetarit ka qenë që edhe unë të paktën jam i mendimit që kjo hartë zonale mos me kaluar edhe mos me iu caktuar e drejta e ndërtimit sepse Mitrovica po tkurret dhe nuk jam i sigurt edhe nuk dua me

përkrahë, e pastaj vije drejtori dhe e shtynë këtë pikë tutje që prapë është e pasqarueshme. Po e marr një shembull, një vijë e ndërtimit i cili i plotëson kushtet e ndërtimit por dallon në vijën e ndërtimit në koeficient të ndërtimit, është e pakapshme, vija e njëjtë e ndërtimit një pjesë 8 katëshe e një pjesë 12 katëshe, kjo mua po ma vranë syrin dhe e dyta nëse është mundësia që ne si anëtarë të Kuvendit të pajtohemi që kësaj zone të ndërtimit t'iu shtohet koeficienti të gjithëve për nga një.

Edison Tërnavë: Shtimin e koeficientit nuk e lejon ligji, ky koeficient është caktuar në bazë të numrit të banorëve. Nëse ju jeni të pajtimit ne mund ta sjellim kompanisë hartuese në një takim me ju ku mund ta sqarojnë në detaje Hartën Zonale.

Xhyljeta Imeri: Sa i përket Hartës Zonale, ne kemi ankesa të banorëve të Vaganicës ku në një pjesë ku ata banojnë, pra që është zonë e banimit në hartë është paraqitur si zonë komerciale, në Vaganicë nuk ka asnjë vend aty që mund të vendoset si zonë komerciale, ndërsa sa i përket ndërtimit të ndërtesave është e papranueshme betonizimi gjithandej, mungesë e hapësirave gjelbëruese, mungesë e këndit të lodrave të fëmijëve, duhet të ketë standarde, a ka plan se cilat standarde do të plotësohen që të merret leja apo si shkon kjo punë, kjo do të sjell një dëm afatgjatë për neve, duhet të pyeten ekspertët e ambientit, a e din sa do të rritet nxehësia nga betoni, ndërsa kur kemi gjelbërim ulen edhe temperaturat, ka edhe shumë pika tjera që duhet të diskutohen. Më intereson edhe pjesa të Lagja e Romëve, e di që ka qenë një marrëveshje sipas bashkësisë ndërkombëtare që ata nuk kanë drejtë t'i shesin ato prona, e as ne nuk kemi të drejtë me i ble, çka është vendosur me hartë zonale për atë pjesë.

Edison Tërnavë: Është çështje procedurale gjyqësore, është masë e përkohshme që ne nuk na takon të përziemi, por ne vetëm mund të bëjmë planifikim për periudhën 8 vjeçare. Me hartë zonale është paraparë banim i mesëm. Ndërsa sa i përket lejeve të ndërtimit ka kritere, ka kushte. Nuk duhet të bëhet pranimi teknik nëse nuk janë respektuar të gjitha kriteret.

Xhyljeta Imeri: Më e keqja është se nuk po ndëshkohet askush edhe pse nuk po respektohen kriteret.

Vesël Neziri: Krejt këto probleme negative që janë grumbulluar e që ne po i diskutojmë janë si pasojë e asaj që kemi pa deri sot, sa herë e kemi diskutuar që ata që ndërtojnë banesat e kanë obligim me e rregulluar edhe infrastrukturën, asnjë banesë që është ndërtuar nuk është rregulluar rruga, askush nuk është ndëshkuar, fatkeqësisht nuk po funksionon asgjë, të njëjtat kompani po ndërtojnë dhe asnjë standard nuk po respektohet, kemi nevojë për një plan, prandaj unë jam që kjo pikë të miratohet dhe të shkoj në Kuvend.

Kryesuesja e mbledhjes Vesa Broja: Propozoj që kjo pikë të shtyhet për javën e ardhshme, do të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e KPF-së vetëm me këtë pikë dhe do të ftohet kompania hartuese të na japë të gjitha sqarimet e nevojshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e jashtëzakonshme të KPF-së.

Pika 4

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kërkesën për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999".

Erseka Barani: Nëse e miratojmë këtë kërkesë ne u hapim derë edhe organizatave dhe individëve tjerë të kërkojnë subvencionim për këtë çështje e dihet që parimisht para dy-tri viteve edhe si Kuvend edhe si KPF jemi pajtuar që të mos sjellim kërkesa të tilla, të gjitha i kemi refuzuar dhe asnjëra prej tyre nuk e ka pasur shumën 12.000 €. Edhe kjo pikë të vije për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KPF-së dhe të vije e kompletuar, sepse nuk besoj se do të jetë vetëm kjo

kërkesë, ne do të kemi edhe kërkesa tjera dhe ta përkrahim njërin e mos t'i përkrahim tjerat do të dalim jo serioz.

Hysen Muzliukaj: Ne e kemi miratuar edhe një pikë për botim të një libri, a është paguar ky libër.

Kryesuesja Vesa Broja: Nëse nuk gaboje është paguar.

Drita Kadriu: Për shkak të specifikave që u përmendën unë kam dashtë që kjo pikë të sillet në KPF sepse me miratimin e saj ne e dëshmojmë me dokument se kemi kaq nxënës të vrarë, ne për Kuvend do ta kompletojmë dokumentacionin dhe do ta sjellim me kohë.

Xhylljeta Imeri: Dokumentimi i krimeve të luftës është shumë me rëndësi dhe besoj se të gjithë jemi me e përkrahë, unë kam pyetje për Drejtoreshën se këto 12.000 € a do të merren nga subvencionimi që janë ndarë për nxënës për bursat e nxënësve të shkollës "Arkitekt Sinani".

Drita Kadriu: Po, 8.000 € bursë për nxënësit e shkollës teknike janë të mjaftueshme.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kërkesën për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999".

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999". Obligohet Drejtorja për Arsime që Kuvendit të Komunës t'i ofrojë propozim-vendimin në harmoni me Rregulloren Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve, propozim-vendimi të harmonizohet me Zyrën Ligjore. Kërkesa për subvencionim të "Monografisë së nxënësve të vrarë të Mitrovicës gjatë luftës në Kosovë 1998-1999" (e harmonizuar) i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:20 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Merita PRETEND

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

